



UENDI ZAIMI

Pas këshillimit për karrierë, Uendi gjen mundësi punësimi

Uendi është vajza 22-vjeçare nga Tirana, që një ditë vendos të marrë pjesë në disa konsulta individuale në Zyrën e Këshillimit.

Për të gjithë të rinjtë sot, duket gjithmonë e më shumë e nevojshme një vend ku të merren informacione për karrierën, një zyrë ku orientimi që jepet dhe metodikat që përdoren e ndihmojnë të riun të mos ndihet konfuz. Këtë ndihmë e kërkoi dhe Uendi. Të rinjtë sot ndiejnë mëdyshje thuajse për gjithçka. Mëdyshje të zgjedhin universitetin me idenë e një investimi për të ardhmen, dilemë kur vjen dita të zgjedhin një profesion për të punuar, akoma më të pasigurtë ata ndihen kur duhet të gjejnë një punë kur nuk kanë as profesionin, as idenë se ku duan të punojnë.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS
ALBANIA



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

"Kam marrë pjesë në disa trajnime të ndryshme si Këshillim për CV, Këshillim për karrierën dhe shikimin e punëve të ndryshme për profilin tim. Në trajnimin e bërë nga BIESS për planin e biznesit mora shumë informacione për çka do të më vlejnë mua nesër. Qëllimi im ishte të zhvillohesha sa më shumë dhe si të pasuroja CV-në time", tregon Uendi për arsyet pse u nxit të bëhej pjesë e disa trajnimeve të mbështetura nga RisiAlbania.

Uendi është nga ato raste që pasi trokiti në Zyrën e Këshillimit, mësoi se si të vazhdonte më tej. Si të gjithë të rinjtë, të cilët shpesh rrëfejnë se si nuk ndihen në konfidencat e duhura për të marrë një vendim racional, Uendi u informua në Zyrën e Këshillimit të Karrierës se si ajo mund të zhvillohej duke marrë pjesë në trajnime apo projekte të ndryshme.

Projekti BIESS e ndihmoi Uendin për krijimin e një plani biznesi, trajnimin për të krijuar një CV të saj që e kërkon tregu sot, si dhe e këshilloi për karrierën. Të gjitha këto e kanë bërë Uendin të ndihet më e përgatitur për sfidat në tregun e punës.

"Sot jam shumë e kënaqur me zgjedhjet e mia, sepse realizova dhe një CV të mirë përballë konkurrencës së madhe në tregun e punës, që do të thotë se duhet të jesh nga më të mirët e të mirëve tek konkurrenca dhe për këtë duhet punë", thotë Uendi, e cila shton se falë këtyre trajnimeve, pjesëmarrjes së saj në projekte, dhe zbatimit të asaj çka u këshillua, ajo gjeti mundësinë e punësimit si IT.

"Nuk jam e sigurt nëse do isha apo jo tek ky drejtim që jam, po mos të ishte për këshillimin. Mendoj se Zyra e Këshillimit është një mision për të ndihmuar të gjithë të rinjtë për të bërë një zgjedhje sa më të zgjuar. Më ndihmoi në gjetjen e një mundësie punësimi dhe pasurimin e CV. Sot, punoj si specialiste IT në Rinas prej 4 muajsh".

Uendi tregon se mundësitë e reja të punësimit erdhën si pasojë e këtyre trajnimeve, për të cilat thekson se dhe pse është e punësuar, akoma do të merrte pjesë në trajnime nëse do i jepej mundësia. Sipas Uendit, të rinjtë nëse ndjekin këshillimin e karrierës, do të mund të shohin të ardhmen e tyre me një perspektivë tjetër.

